# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-412238**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Thirrja e Berishës nga Amerika: Diaspora të bashkohet me protestën qytetare në Shqipëri që prej tre muajsh kërkon largimin e Ramës |
| ADRESA | `https://dosja.al/politike/thirrja-e-berishes-nga-amerika-diaspora-te-bashkohet-me-protesten-qytet-i512818` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 16:48:23 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 6 shtator 2026, 16:45:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6d264933daa5947f6b254a43e4fbb1d6c670ad4de831c40e72bb6cc99beed476` |
| TEKSTI | `a49736dab70ed73c0b5be3ea19fa51f77251eb9a662b7cef09a2f7ebaf903d83` |
| PAMJA | `34e53a6aa174ed0551072810a3f77462e6048a8cf2ced3488239f5c3da50e8c0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ea83fb83c0baee5f5a862f5c8acb8833a4b64dce6eb75f14bae8257f117c97d0` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `68b473e302cc781fa81a9fb6ddcb464cf9103c6ca61b277406c21d5dd6bba777` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ea83fb83c0baee5f5a862f5c8acb8833a4b64dce6eb75f14bae8257f117c97d0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES
2 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

### "Nuk shitet Shqipëria"/ 99 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

"Dy kërkesa janë urgjente, dorëheqja e Ramës dhe qeveria teknike"/ Protestuesi: Nesër 100-ditëshi, protestë k...

4 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

### "Diaspora në SHBA fat i mirë i kombit shqiptar"/ Berisha me shqiptarët në New Jersey: Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata në vendin e tyre

Berisha nga SHBA: Nga kjo platformë kam një kushtrim për të gjithë shqiptarët në botë, Shqipëria du...

5 ORE ME PARE LIVE UPDATES E. D

### Zjarret në vend/ Flakët "përpijnë" masivin pyjor në Tërbun të Pukës, rrezikohet 'kurora' e qytetit! Situata problematike edhe në Fier (PAMJET)

Vatër zjarri në kodrat e Peshkëpisë në Selenicë, era favorizon përhapjen e flakëve 6 Shtator, 16:26 ...

5 ORE ME PARE LIVE UPDATES E.d

### Operacion anti-drogë në Sarandë/ Arrestohen 20 persona, mes tyre 'koka' e grupit Altin Arapi! Shisnin hashash e kokainë pranë plazheve (EMRAT+PAMJET)

Zbulohet si funksiononte skema e shitjes së drogës në Ksamil, anëtarët e grupit vinin nga Tirana dhe Elbasani vetë...

Politike

# Thirrja e Berishës nga Amerika: Diaspora të bashkohet me protestën qytetare në Shqipëri që prej tre muajsh kërkon largimin e Ramës

Ai e cilësoi ripopullimin e vendit si kushtin e të gjitha kushteve dhe tha se Partia Demokratike do të ndërmarrë politika për rikthimin e emigrantëve dhe mbështetjen e familjes.

6 Shtator 2026, 18:45 Nga E. D

Thirrja e Berishës nga Amerika: Diaspora të bashkohet me

Sali Berisha

**SHBA**- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, i ka bërë thirrje diasporës në SHBA që të bashkohet me protestën qytetare në Shqipëri që prej tre muajsh kërkon largimin e Ramës. Gjatë takimit me shqiptarët e Amerikës, në New Jersey, Lideri i opozitës ngriti alarmin për shpopullimin e Shqipërisë, duke deklaruar se në dekadën e fundit mbi 1 milion shqiptarë janë larguar drejt vendeve të Shengenit.

Ai e cilësoi ripopullimin e vendit si kushtin e të gjitha kushteve dhe tha se Partia Demokratike do të ndërmarrë politika për rikthimin e emigrantëve dhe mbështetjen e familjes. Berisha akuzoi gjithashtu qeverinë për keqadministrim të pasurive, korrupsion dhe dobësim të institucioneve.

*"Miq, 10 vite Shqipëria ka përjetuar shokun demografik më të madh se të gjitha kohërat. Në 10 vite, 1 milion e 99 mijë shqiptarë janë larguar në zonën e Shengenit. Po të llogarisim dhe zonat e tjera, 47% e kombit ka ikur nga Shqipëria. Lëvizja e lirë sigurisht lejon njerëzit të shkojnë ku të duan, por unë ju njoftoj këtu se nga viti 2007 në vitin 2014, çdo vit, numri i shqiptarëve në Shqipëri është rritur, rritur, rritur. Ndaj dhe, ripopullimin e Shqipërisë, ne duhet ta shohim si kushtin e të gjitha kushteve, që kombi ynë, mijëravjeçar, të mos gllabërohet nga abiset e historisë. Dhe ju keni një rol të jashtëzakonshëm në këtë vend të bekuar. Keni një mundësi të madhe, me përfaqësuesit tuaj, ju më shumë se kushdo tjetër në çdo vend tjetër, mund të luani një rol parësor në këtë betejë, me të keqen në Shqipëri.*

*Miq, sot regjistri i gjendjes civile të shtetit tregon se lindjet janë të barabarta me ato që ishin 100 vite më parë, kur shqiptarët në Shqipëri ishin më pak se 1 milion banorë. Është koha për veprim! Është emergjencë! Rruga e rikthimit, e ripopullimit kalon nga largimi i Edi Ramës. Partia Demokratike ka një program, e cila nga themelimi i saj gjer sot, ka patur interesin e parë, interesin kombëtar, e cila vendos familjen në themel të shoqërisë, e cila në këtë situatë të krijuar dramatike, do bëjë gjithçka me ripopullimin e Shqipërisë, për ripopullimin e Shqipërisë.*
*Do bëjë gjithçka që ju, të riktheheni në dheun tuaj. Besoj se ju jeni të bindur, se nuk ka një vend të dytë në botë, me pasuritë përrallore që kanë ato 28 mijë kilometra katrorë që ka Shqipëria. Pasuri të nivelit botëror.*

*Pasuri me të cilat banorët e saj mund të bëhen banorët më të prosperuar, më të pasur të rajonit dhe të Evropës.*
*Por ato pasuri kërkojnë administrim, kërkojnë ligjin. Kërkojnë që të mos jenë mallkim për qytetarët, por të shtrohen në të mira për qytetarët. Sot shqiptarët janë qytetarët më të keqpaguari në Ballkan dhe në Evropë*

*Në fakt, pak vite më parë, ata merrnin pensionet dhe rrogat më të larta në të gjithë rajonin. Dhe në fakt, ata sot duhet të ishin pa asnjë lloj mëdyshje, me mesataren evropiane. Por pasuritë e tyre plaçkiten, grabiten.*
*Dhe ligji bllokohet. Imunitetet nuk hiqen, përdoren mandatet e krimit për të bllokuar prokurorin.*

*Të gjitha këto janë thirrje për ne. Shqipëria ka jetik vendosjen e shtetit ligjor, funksionimin e institucioneve, luftën me zero tolerancë ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Prej tre muajsh, rinia dhe qytetarët e Tiranës janë angazhuar në një protestë, më të madhen që nga vitet 90. Në këtë protestë, ata kërkojnë largimin e Edi Ramës. Kërkojnë veprimin, funksionimin e institucioneve. Kërkojnë mbrojtjen e pasurive publike, dhe ai sillet si një tiran i vërtetë ndaj tyre. Ndaj dhe unë ju bëj thirrje ju, i bëj thirrje diasporës shqiptare kudo në botë, të japë kontributin e saj në këtë protestë. Partia Demokratike e mbështet fuqishëm atë,"* tha Berisha./**Dosja.al**

sali berisha

**Sondazh**

Poll

Politike

6 Shtator 2026, 18:31
E. D

### "Beteja jonë është për Shqipërinë"/ Berisha: Kam besim se SHBA do t'i ndihmojnë shqiptarët në betejën kundër narkoshtetit

Sali Berisha TIRANË- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha gjatë takimit me shqiptarët në Amerikë, deklaroi se largimi i E...

Politike

6 Shtator 2026, 18:16
E. D

### Berisha nga SHBA: Nga kjo platformë kam një kushtrim për të gjithë shqiptarët në botë, Shqipëria duhet të çlirohet nga narkoshteti me në krye Edi Ramën

Sali Berisha SHBA- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, deklaroi se Shqipëria po përballet me një situatë të rënd&e...

Politike

6 Shtator 2026, 18:05
E. D

### "Mirënjohje presidentit Trump dhe sekretarit Rubio"/ Berisha me shqiptarët në SHBA: Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata në vendin e tyre

Sali Berisha TIRANË- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha e ka cilësuar takimin me shqiptarët e Amerikës, në N...

Politike

6 Shtator 2026, 17:52
E. D

### Berisha me shqiptarët në Amerikë: Diaspora në Shtetet e Bashkuara është fati i bardhë, fati i mirë i kombit shqiptar

Sali Berisha SHBA- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka vlerësuar rolin e diasporës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Am...

Politike

6 Shtator 2026, 17:42
E. D

### Mitsotakis: Greqia mbështet Integrimin e Ballkanit Perëndimor, por Shqipëria duhet të garantojë të drejtat e minoritetit grek

Kyriakos Mitsotakis GREQI- Kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis ka deklaruar se Greqia mbështet në mënyrë të qëndrueshme pe...

Politike

6 Shtator 2026, 17:30
E. D

### Nis takimi i Sali Berishës me shqiptarët në New Jersey

Sali Berisha SHBA- Takimi i Kryedemokratit Sali Berisha me shqiptarët në New Jersey ka nisur. Lideri i opozitës ësht&eum...

Politike

6 Shtator 2026, 17:11
E. D

### VIDEO/ Këlliçi nga New Jersey: Takimi më madhështor i organizuar ndonjëherë nga një politikan shqiptar në SHBA

Belind Këlliçi SHBA- Nënkryetari i PD, Belind Këlliçi, ka përcjellë një videomesazh nga New Jersey, në pra...

Politike

6 Shtator 2026, 12:22
I.A

### VIDEO/ Berisha me përfaqësuesit e Diasporës në SHBA: 46% e shqiptarëve janë larguar nga regjimi i drogës dhe paratë e narkotikëve

Sali Berisha SHBA- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, e cilësoi shpopullimin, ekonominë dhe ndikimin e krimit të organizuar si p...

Politike

6 Shtator 2026, 12:03
I.A

[Pagat e magjistratëve, Rama: Secili institucion është në vendin e vet, çdo gjë tjetër është humbje kohe]

TIRANË- Kryeministri Edi Rama ka reaguar lidhur me çështjen e pagave të magjistratëve dhe gjyqësorit. Në një postim ...

Politike
6 Shtator 2026, 09:56
I.A

["Ja ku ka gabuar SPAK"/ Rama përballë 300 pyetjeve: S'kam ndërmend të zgjedh pasardhës!]

Edi Rama TIRANË- Kryeministri Edi Rama ka paralajmëruar rinisjen e podkastit të tij "Flasim", me një intervistë ndrysh...

MË SHUMË

## editoriale

Editorial 3 Shtator 2026, 07:38 **Enver Robelli**

[Pse po rebelohen deputetët e LDK-së]

Enver Robelli Të "rebeluarit" e LDK-së vetëm duhet t'u tregojnë qytetarëve se për çka po "rebe...

Editorial 31 Gusht 2026, 16:22 **Andi Bejtja**

[Make Albania Affordable]

Andi Bejtja Nuk ka nevoje te shikosh te dhenat e Eurostat ku nenvizohet se cmimet e ushqimeve ne Shqiperi jane rritur 5 here me shume se mesatarja europian...

**Në vëmendje**

Aktualitet 6 Shtator 2026, 20:56 E. D

[PAMJE dramatike nga zjarri në Tërbun të Pukës, flakët shkrumbojnë masivin pyjor]

pamjet TIRANË- Pamje dramatike janë publikuar nga zjarri në masivin pyjor të Tërbunit, mbrëmjen e sotme. Siç shih...

Art&Argëtim 6 Shtator 2026, 16:58 E.M

["The One About Matthew Perry"/ Nga Chandler Bing te betejat personale, Netflix dokumentar për aktorin ikonik të F.R.I.E.N.D.S]

SHBA- Matthew Perry, aktori më i dashur amerikano-kanadez, i njohur më së miri për rolin ikonik të Chandler Bing (1994–200...

Aktualitet 6 Shtator 2026, 15:43 E. D

[Nga "Boraqi" te "Vis Korçari"/ Kush janë të arrestuarit e operacionit anti-drogë në Sarandë, të përfshirë në drogë, plagosje e vjedhje]

SARANDË- Një operacion anti-drogë në Sarandë çoi në kapjen e 20 persona, mes tyre edhe 49-vjeçarin Altin Arap...

**më të klikuarat**

Politike 6 Shtator 2026, 09:56 I.A

["Ja ku ka gabuar SPAK"/ Rama përballë 300 pyetjeve: S'kam ndërmend të zgjedh pasardhës!]

Edi Rama TIRANË- Kryeministri Edi Rama ka paralajmëruar rinisjen e podkastit të tij "Flasim", me një intervistë ndrysh...

Bota 6 Shtator 2026, 10:42 I.A

[Irani u kundërpërgjigjet sulmeve amerikane, sulmojnë dronin detar amerikan]

IRAN- Irani tha të dielën se forcat e tij sulmuan një dron detar amerikan që po përpiqej të hynte në Ngushticën e Horm...

Aktualitet 6 Shtator 2026, 14:59 E. D

[Përplasja e biznesmenëve në Vlorë/ Gjykata jep masat e sigurisë për të arrestuarit, Luan Muçës i caktohet "detyrim paraqitjeje"]

VLORË- Gjykata e Vlorës ka dhënë masat e sigurisë për pesë personat e arrestuar në lidhje me ngjarjen e ndod...

Aktualitet 6 Shtator 2026, 15:52 E. D

[Përplasja me Vasil Bedinajn, Luan Muça tregon versionin e tij të ngjarjes: Historia e gjobës është e sajuar]

Luan Muça VLORË- Pronari i Delta Group, Luan Muça ka treguar versionin e tij lidhur me përplasjen me biznesmenin, Vasil B...

## insights

Insights 2 Shtator 2026, 10:34 **Idriz Konjari**

[**Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?**]()

Idriz Konjari Shqipëria po hedh hapa të sigurt drejt integrimit në Bashkimin Evropian, por do te ishte gabim që integrimi evropian t&eu...

Insights 28 Gusht 2026, 21:11 **Bledian Koka**

[**Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?**]()

I strukur ne nje qeli te IEVP Durres, nen "shoqerine" e gardianit te turnit, Erion Veliaj ka arritur te siguroje nje leter zyrtare te cilen ka hedhur per te d...

Insights 19 Gusht 2026, 11:08 **Fjola Graçi**

[**REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"**]()

TIRANE- Pamje të shëmtuara, të neveritshme, rrëqethëse për dikë dhe "anormale" për një tjetër. K...

Insights 13 Gusht 2026, 16:08 **cim peka**

[**Kur salla kthehet në pasqyrën e liderit**]()

Mbushja e sallës së Kuvendit me përfaqësues të diasporës duhej të ishte një demonstrim force për Albin Kurtin. Po...

**Moti**

[Powered by Tomorrow.io]()

## PAMJE dramatike nga zjarri në Tërbun të Pukës, flakët shkrumbojnë masivin pyjor

**PAMJE dramatike nga zjarri në Tërbun të Pukës, flakët shkrumbojnë masivin pyjor**

**99 ditë revoltë kundër qeverisë Rama/ Qytetarët marshojnë drejt kryeministrisë: Rama jepe dorëheqjen**

**Bie zjarr pranë banesave në Krastë të Elbasanit, në rrezik dy shtëpi**

**Thirrja e Berishës nga Amerika: Diaspora të bashkohet me protestën qytetare në Shqipëri...**

**Berisha: Kam besim se SHBA do t'i ndihmojnë shqiptarët në betejën kundër narkoshtetit**

**Berisha nga SHBA: Nga kjo platformë kam një kushtrim për të gjithë shqiptarët në botë**

**Berisha me shqiptarët në SHBA: Ata që firmosën ndalimin tim, sot janë non-grata në vendin e tyre**

**Berisha me shqiptarët në Amerikë: Diaspora në Shtetet e Bashkuara është fati i bardhë...**

**Këlliçi nga New Jersey: Takimi më madhështor i organizuar ndonjëherë nga një politikan shqiptar**

**Katër vatra zjarri regjistrohen në pyllin e Semanit, flakët përhapen me shpejtësi nga era**

**"Hajde ikim se na q*** nanën"/ Shqiptarët hyjnë në shtëpinë e influenceres spanjolle...**

**Momente nga takimi i Berishës me përfaqësuesit e Diasporës në SHBA: 46% e shqiptarëve janë larguar..**

**Zjarr në Syrin e Kaltër, digjen 4 kioska tregtimi**

**Pagat e magjistratëve, Rama:Secili institucion është në vendin e vet, çdo gjë tjetër është humbje...**

**"Ja ku ka gabuar SPAK"/ Rama përballë 300 pyetjeve: S’kam ndërmend të zgjedh pasardhës!**

**Zjarri vijon prej 24 orësh në kodrat e Bardhajve, kërkohet ndërhyrje nga ajri**

**Banesa, ullishte e sipërfaqe pyje të shkrumbuara, ja çfarë la pas zjarri që "përpiu" Himarën**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.